

# Fëmijë të sigurtë

Mbi fëmijët dhe sigurinë  
e përditshme



Shqip

Srpski,  
Hrvatski,  
Bosanski

Türkçe

Kurmancî

اللغة العربية

كوردی (سۆرانی)

Français

Español

Svenska

English

فارسی

Soomaali

*Përpiluar nga Hyresgästföreningen së bashku me Konsumentverksamheten në komunën Hagfors.*

*Ekziston në 12 gjuhë*

Kjo broshurë është përpiluar nga Hyresgästföreningen së bashku me Konsumentverksamheten në komunën Hagfors.  
Ekziston edhe si pdf-fil ta shkarkosh nga vebadresa:

[www.hyresgastforeningen.se](http://www.hyresgastforeningen.se) [www.hagfors.se](http://www.hagfors.se) [www.konsumentverket.se](http://www.konsumentverket.se)

**Hyresgästföreningen Region Mitt**

Zyra e rrethit: Box 360, 651 08 Karlstad

Adresa e selisë: Kungsgatan 1

Telefoni: 054-17 52 00

**Hagfors kommun**

Konsumentverksamheten

683 80 Hagfors

Telefoni: 0563-185 00

© tekstet: Konsumentverket.

Përkthimi dhe grafika: Tamarind AB.


Shtypur në: Redners Offsettryckeri AB.

Gusht 2003.

## 15 këshilla mbi lodrat

*Kur të blesh lodra fëmijëve nën moshën tre vjeçare, duhet të jesh jashtëzakonisht i kujdesshëm.*

1. Mos blej “bërlllok të lirë”. Malli i markave të mirënjohura në tregun e zejeve të ndryshme është shpesh më i mirë. Kij kujdes të jashtëzakonshëm nëse, megjithatë, blen lodra në një treg apo në ndonjë vend shitjeje mallrash të rastësishme.
2. Së pari pyet, pastaj blej. Kërko informacion në shitore mbi lodrën dhe kërko librin e udhëzimeve. Preferohet që udhëzimi të jetë me shkrim. Të gjitha vërejtjet duhet të jenë në gjuhën suedeze.
3. Shtazët e buta dhe lodrat duhet ta tolerojnë larjen. Sytë, hundët, kopsat dhe detalet tjera, duhet të jenë të kapura/ngjitura mirë.
4. Mos blej lodra të plastikës së brishtë, e cila prishet lehtë. Fëmijët e moshës nën tre vjeçare, duhet të kenë lodra jashtëzakonisht të forta. Ato duhet të jenë të qëndrueshme edhe po që se t’i hedhësh, t’i goditësh apo t’i kafshosh, pa u prishur ato.
5. Hedhi pakot e holla të plastikës, para se t’i merr ato fëmija. Hedhi, poashtu, edhe të gjitha lodrat e prishura.
6. Prej të gjitha shenjat plastike, penjtë plastik të etiketës së çmimit etj. Gjërat e vogla, të cilat mund të shkëputen dhe mund të futen në gojë, mund të jenë një rrezik për fëmijën.
7. Kij kujdes me gjërat e vogla në vezë-çokollatë. Ato mund të jenë të rrezikshme nëse fëmija i fut në gojë dhe ato i mbeten në fyt.
8. Rraketakët, rrathë kafshimi dhe lodrat tjera për fëmijë, të cilët fëmijë akoma nuk mund të rrinë vet ulur, nuk guxojnë të kenë lodra me pjesë të dalura ca jashtë sipërfaqe të lodrës ose të ketë pjesë të ngjitura, të cilat mund të bienë, dhe nëse i fut ato në gojë, mund t’i bllokojnë kanalet e frymëmarrjes tek fëmija.
9. Preke lodrën. Materiali i rrezikshëm me të cilin është e mbushur lodra zakonisht kërcet (p.sh. margaritar plastik) ose ndjehet kokërrzor. E pyet shitësin se me çfarë materiali është e mbushur lodra. Nuk duhet të ketë as të qepura të brishta, të cilat mund të shqepen. Provo ca vet ta tërheqësh atë. Shtazët e buta kanë shpesh një pikë të dobët, me të qepura të brishta, në mes të këmbëve.
10. Topat dhe gjërat tjera të rrumbullakëta, duhet të jenë së paku pesë centimetra në diametër.
11. Dysho në plastikën e butë e cila kundërmon keq. Kjo mvaret ndoshta nga se lodra përmban lëndë të dëmshme kimike.
12. Shkumësa, lapsa-ngjyrërash, lapsa-shajaku e të ngjashme, duhet të jenë të parapara për fëmijë të vegjël. Lapsat për të rriturit mund të jenë të rrezikshme t’i thithë apo lëpijë fëmija ose të vizatojë me ato në lëkurë.
13. Spangot, lidhësit e lodrave, krevat fëmijësh, dhe karrocë-lodra fëmijësh, nuk guxojnë të jenë më të gjata se 22 centimetra. Kjo vlen edhe për lodra të fëmijëve të vegjël me vjegëza, bulat etj, të cilat mund të krijojnë një qafore.



14. E heq lodrën e krevatit të fëmijës e cila është e varur mbi krevatin, atëherë kur fëmija ka filluar të ngritet në duar dhe në gjunjë, diku rreth moshës gjashtë mujore. Fëmijët kanë mbetur varur mbi lodrën, duke u rrezikuar kështu të mbyten.
15. Tento të shmangesh nga lodrat që lëshojnë zë të lartë. Pistoleta, telefona mobil, dhe lodra me zukatje, mund ta dëmtojnë aftësinë e dëgjimit tek fëmija.

Nëse ke diçka për të pyetur mbi lodrat dhe sigurinë e tyre, atëherë e kontakto udhëzuesin e konsumit të komunës tënde.

## Zëri i lartë

*Ka shumë lodra joshëse dhe të mira të cilat lëshojnë zë, cingërojnë, zukatin, i bien një melodie, shushuritin, fishkëllon, ose cingëron. Shumica e tyre janë plotësisht të parrezikshme. Por, ka edhe lodra të rrezikshme, të cilat mund ta dëmtojnë aftësinë e dëgjimit tek fëmija, njëherë e përgjithmonë.*

Për një kohë të gjatë nuk kanë ekzistuar rregulla se sa zë/zhurmë lejohet të lëshojnë lodrat. Por, më 31 janar 2001 u miratuan rregulla të reja të UE në këtë lëmi. Rregullat përfshijnë lodrat të cilat lëshojnë zë nga rënia shumë e shkurtër, nga shkrepja ose zë eksplozivi, e ashtuquajtur zhurmë impulsive, lodra që mbahen afër veshit.

### Pluhur pëlçitës

Një pistoletë me pluhur pëlçitës lëshon një zë shumë të shpejt, çka truri nuk është në gjendje ta kuptojë lartësinë e zërit. Thjesht, nuk dëgjohet se zëri është i dëmshëm.

Pistoleta me pluhur pëlçitës lëshon një zë aq të lartë, mjafton vetëm një e shtënë për të shkaktuar dëm të përhershëm të aftësisë së dëgjimit. Rreziku është më i madh kur e shtëna dhe zëri i lartë është më afër veshit. Pikërisht, problemi me pistoletën me pluhur pëlçitës, nuk është zgjedhur akoma, në kuadër të standardeve të reja të UE, mbi nivelin e zërit të lodrave.

Nëse fëmijët patjetër duan të luajnë me pluhur pëlçitës dhe me pistoletë me pluhur pëlçitës, atëherë është më mirë që ata të luajnë jashtë shtëpisë. Nuk guxon t'ia drejtoni pistoletën njëri tjetrit, sidomos jo në drejtim ose në afërsi të fytyrës apo veshit.

### Fishekzjarre

Fishekzjarret dëmtojnë aftësinë e dëgjimit njësoj si pluhuri pëlçitës. Disa fishekzjarre, pos kësaj, kanë një fitil të shkurtër, sa që nuk arrihet të ikësh nga vendi, para se ajo të eksplodojë.

### Zë nga shkrepja

Edhe lodrat të cilat lëshojnë zë nga shkrepja, mund të lëshojnë një zë aq të lartë sa që mund ta dëmtojnë aftësinë e dëgjimit. Kjo është posaçërisht serioze, pasi që zërin që ato lëshojnë nuk shkaktojnë dhimbje

ose ndihen aq lartë, por, megjithatë, këto mund ta dëmtojnë veshin. Mos i provo në shitore – në vend të provës, pyet për nivelin e zërit, dhe preferohet të shmangesh nga ky lloj lodrash.

### **Zë konstant**

Telefona-lodër, vetura me telekomandë, vegla-lodër si dhe shumë lodra të tjera elektronike, lëshojnë shpesh një zë të lartë dhe konstant. Lodrat e këtij lloji mund t'i provosh në shitore. Kij posaçërisht kujdes me telefonat mobil dhe lodrat tjera të cilat fëmija i mban afër veshit. Nëse zëri është i lartë dhe i bezdisshëm kur ta mbash lodrën pranë veshit, mos e blej atë.

### **Për më të vegjëlit**


Zë si zukatje, kutizë-lojë, raketake dhe lodra të tjera të fëmijëve të vegjël të cilat lëshojnë zë, kanë shpesh nivel të pranueshëm të nivelit të zërit. Por, provo ta mbash lodrën afër veshit, para se ta blesh atë. Nëse kjo ndodhet në krevat, në afërsi të veshit të fëmijës, kjo mund ta irritojë apo lëndojë/dëmtojë fëmijën, nëse zëri është tepër i lartë. Kij parasysht se zëri, si zukatje që të shpon veshët, ky zë përforcohet edhe më shumë në kanalën e ngushtë të dëgjimit të fëmijës. Të rriturit që luajnë me fëmijët e vegjël, ndoshta e mbajnë lodrën që zukat, raketaken ose kutizën-lojë, afër veshit të fëmijës.

## **Biberonët**

*Lexo në pako kur të blesh biberon. Aty duhet të shkruan që biberoni është tip i pranuar, që i plotëson direktivat e parashtruara nga Enti i Konsumit.*

Bërë vet një kontroll sigurie:

- Një biberon nuk guxon të ketë spango, shirit apo diçka tjetër, që mund të lidhet rreth qafës së fëmijës. Ka ndodhur që fëmijët e vegjël mbërthehen/lidhen dhe mbyten.
- Spangoja e mbajtjes së biberonit nuk guxon të jetë më e gjatë se 22 centimetra, Kjo është masa përreth qafës së një fëmije gjashtë mujor.
- Armatura/pjesa e gjerë, duhet të jetë aq e madhe, ashtu që të mos mund t'i futet fëmijës në gojë. Preferohet të ketë vrimë ventilimi.
- Shih pjesën që e thithë. Ajo nuk guxon të ketë vrimë ose shenja nga e gërvishtura, e cila ngadalë mund të shkëputet nga armatura e vet.
- Provo e tërhiqe pjesën thithëse të biberonit, secilën herë, para se t'ia japësh fëmijës. Materiali, me kalimin e kohës, bëhet i brishtë.



## Fatkeqësi me lodra: Lexo shënimet dhe tekstin e vërejtjeve

*Një nga rreziqet më serioze të fatkeqësive me lodra janë kur fëmijët futin diçka në gojë dhe kjo ju mbetet në fyt. Ndodhin, poashtu, fatkeqësi kur fëmijët lëndojnë sytë dhe dëgjinin. Shih shënimin CE si dhe vërejtjet në kutia.*

Lodrat mund të jenë shkaktarë të fatkeqësive në mënyra të ndryshme. Shpesh ka të bëj me ngjarje si p.sh. fëmija rrëzohet nga lodrat e tija, ose i bie në kokë lodra që e gjuan tjetri, ose ngatërrohet në to. Mirëpo, ndodhin edhe disa fatkeqësi ose rreziqe të tjera që kanë të bëjnë me vet lodrën.

### I mbetet në fyt

Shumica e lajmërimeve që merr Enti i Konsumit kanë të bëjnë me lodra të përbëra nga pjesë të vogla, të cilat pjesë fëmijët e vegjël i futin në gojë. Në rastet më të rënda, kjo mund të shkaktojë mbytje ose lëndime të tjera. Disa shembuj janë, gogla plastike, raketake të prishura, sy dhe hundë të shkëputura nga kukulla-arushë, pipëza gati të shkëputura të balonave si dhe lodra në vezë-çokollatë. Mund t'i kontrollosh vet lodrat me ndihmën e një cilindri të veçantë të provës, vall mos ato janë të rrezikshme për fëmijët e vegjël.

### Spango të rrezikshme

Një rrezik tjetër për fëmijë të vegjël janë spangot e gjata. Ata mund t'i lidhin ato rreth qafës, ashtu që fëmija nuk mund të merr frymë. Sytë janë poashtu një pjesë e rrezikuar e trupit. Ka ndodhur që shigjeta të forta, lodra-helikopterë dhe aeroplan me katapultë, e qëllonjë fëmijën në sy dhe shkaktojnë verbimin e fëmijës. Një lëmi tjetër që i shqetëson ekspertët janë, lëndimet nga zhurma e lartë. Dihet se niveli i lartë i zërit, mund të shaktojë dëmtim të aftësisë së dëgjimit.

### CE-shenja

Rregulli i parë që duhet shikuar te lodra është të shikosh se a e ka CE-shenjën. Kjo domethënë se prodhuesi garanton së lodra i plotëson kërkesat e përbashkëta të shteteve të UE mbi sigurinë, standardin e lodrave SS EN 71.



Lodra duhet ta ketë edhe shenjën e prodhuesit, emrin e importuesit si dhe markën e prodhimit. Lodrat plotësisht anonime mund të jenë të rrezikshme.

Mos blej lodra pa CE-shenjën. Ato mund të jenë të kualitetit të dobët dhe luajtja me ato mund të jetë e rrezikshme. Mjerisht, nuk mund të besohet se lodrat me CE-shenjë janë të sigurta. Ndonjëherë, ato bëhen me hile. Të gjitha lodrat me CE-shenjën nuk i kanë testuar, para se të arrijnë ato në dollapet e shitoreve. Prandaj, duhet të jesh syçelë.

## Shënim tjetër

Disa lodra duhet të kenë tekst me vërejtje ose shenjën e moshës. Lodrat për fëmijë më të moshuar, mund të jenë të rrezikshme për fëmijët e vegjël. Ekziston një simbol i veçantë me vërejtje në lodra, të cilat janë të rrezikshme, për fëmijë të moshës nën tre vjeçare. Informacion mbi rrezikun ekzistues, duhet të jetë teksti i shënuar pranë këtij simboli. Ndonjëherë, ekziston një vërejtje e shkruar.



## Lexo tekstin e vërejtjes

Teksti i vërejtjes mund të shpjegojë p.sh. domosdoshmërinë që ta kesh kujdes lodrën nga zjarri ose ajo duhet të jetë nën mbikëqyrjen e një të rrituri. Vërejtja duhet të jetë e shkruar në gjuhën suedeze. Shpesh është vështirë për ta gjetur tekstin, pra duhe ta kontrollosh me kujdes pakon.

Shembull i tekstit të vërejtjes:

*”Varning: barn under åtta år kan kvävas av ej uppblåsta eller trasiga ballonger. Nödvändigt med övervakning från vuxen. Håll ouppblåsta ballonger borta från barnen. Kasta genast trasiga ballonger.”* (Vërejtje: fëmijët nën moshën tetëvjeçare mund të mbyten nga balonat e shqyer ose jo të fryrë. Nevojitet mbikëqyrja e një të rrituri. Mbaj balonat jo të fryrë larg nga fëmijët. Hedhi menjëherë balonat e shqyer.)

*”Varning! Ej lämplig för barn under 36 månader. Innehåller smådelar”* (Vërejtje! Jo e përshtatshme për fëmijë nën moshën 36 mujore. Përmban pjesë të vogla.)

## Brezi i shpëtimit

*Fëmijët në anije dhe fëmijët që luajnë në platforma ose buz detit/liqenit, duhet të kenë veshur një brez shpëtimi. Megjithatë, kurrë mos e lë fëmijën pa mbikëqyrje. Një brez i shpëtimit nuk është ndonjë rojë e fëmijës.*

Brezat e shpëtimit për fëmijët e vegjël, duhet të jenë të lehtë për t'ua veshur atyre një i rritur. Por, vështirë për fëmijën për ta zhveshur atë.

## Madhësia tamam

Brezi i shpëtimit për fëmijë, nuk guxon të jetë tepër i madh. Atëherë, fuqia mbrojtëse bie tepër poshtë. Nëse fëmija bie në ujë, do t'i ngritet pjesa e poshtme e trupit tepër lartë, njëkohësisht koka i përmbysset prapa.

Shiritin degëzues nuk duhet shtrënguar tepër. Është e papërshtatshme dhe mund të jep një lundrim të gabuar. Hapësira në mes shiritit dhe degëzimit duhet të jetë përafërsisht pesë centimetra.



## **Provo të lahesh**

Mësoje fëmijën të lundrojë me brezin e shpëtimit dhe të adaptohet kur brezi i shpëtimit dëshiron ta kthen trupin për të lundruar në shpinë. Përndryshe, një fëmijë të vogël mundet lehtë ta kap paniku, kur pa dashje ai/ajo bie në ujë.

Shko në një pishinë të ushtros. Provo të lahesh para çdo sezoni të ri, që ta dish se brezi i shpëtimit funksionon si duhet.

## **Fëmijët nën një vit**

Fëmijët e moshës nën një vit, i pengon mbajtja e brezit të shpëtimit. Në anije më të mëdha munden, në vend të tyre, ta përdorin rripin. Një rrip i fortë i karrocës së fëmijës, lidhur në një vend të përshtatshëm, mund të jetë zgjidhja e këtij problemi. Ose një karrige biçiklete të fëmijës, të lidhur mirë. Por, është e qartë se një brez shpëtimi i tamam, duhet të jetë në anije.

## **Mjete ndihmëse noti**

Në treg ka disa lloje mjetesh ndihmëse noti, ashtu si kuptohet edhe nga vet emri: pikërisht një mjet ndihmës për ta ushtruar notin, por jo pajisje shpëtimi. Është me rëndësi ta kesh këtë parasysh.

## **Të marrësh me qira apo të blesh të përdorur**

Nëse blen një brez shpëtimi të përdorur, kontrollo të qepurit, kopset, shiritat dhe mbulesën e jashtme. Brezat e vjetër të shpëtimit dobësohen në sipërfaqe të pëlhurës. Blej vetëm breza shpëtimi me CE-shenjën.

Në shumë komuna mund të marrësh me qira breza shpëtimi. Ti mund të informohesh, ku mund të marrësh me qira, duke kontaktuar Udhëzuesin e Konsumit të komunës tënde.